



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 743/2 Prot

Tiranë, më 21.12.2020

V E N D I M

Nr.197, datë 21.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ për verifikimin e ligjshmërisë të informacionit, për emërim të përkohshëm, të parregullt, të nëpunësit *** në një pozicion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në të cilin kërkohet certifikata e sigurisë nga DSIK.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të një informacioni të marrë nga një shtetas,

Vërej se:

Nëpërmjet një e-maili, dërguar Komisionerit, protokolluar me nr.743 prot., datë 28.9.2020, është ngritur pretendimi se, nëpunësi ***** i emëruar përkohësisht në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inteligjencës Operative”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i është refuzuar certifikata e sigurisë nga ana e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe aktualisht, megjithëse ky pozicion pune e kërkon pajisjen me një dokument të tillë, ai vazhdon në këtë detyrë, prandaj është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Nga tërësia e dokumentacionit të mbledhur për hetimin administrativ të këtij rasti, konstatohet se, punonjësi ***** është nëpunës civil, i cili ka emërim të përhershëm

në pozicionin “Përgjegjës Zyre”, Zyra e Terminalit të Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenierët, pranë Degës Doganore Durrës (akti nr. 1606/20, datë 13.3.2019, i DAP dhe akti nr. 7217, datë 23.3.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave).

Së fundi, për nevoja të institucionit, me aktin nr. 17031, datë 15.9.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ai është transferuar përkohësisht në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inteligjencës Operative”, në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pranë DPD.

Nga përmbajtja e materialit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet postës elektronike të Komisionerit (e-mail datë 05.10.2020), rezulton se, pozicioni i mësipërm përfshihet në listën e funksioneve organike që për shkak të detyrave të posaçme zyrtare, lind nevoja që të njihen me informacion të klasifikuar dhe në këtë rast, nëpunësi duhet të pajiset me “Çertifikatën e Sigurimit të Personelit” (CSP).

Të gjitha rregullat, fusha e veprimit, procedurat e aplikimit dhe të verifikimit të sigurisë, janë të përcaktuara në Vendimin nr. 188, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, i cili, në pikën 2, të nenit 3, të tij, përcakton si autoritet përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e standarteve të sigurimit të informacionit të klasifikuar, Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

Mbi këtë bazë, sipas përcaktimeve në këtë akt nënligjor dhe sipas Urdhrit nr.155/1, datë 19.6.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për një shtesë në Urdhrin nr.155, datë 2.5.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e listës së funksioneve organike të ministrisë së financave dhe ekonomisë që pajisen me “Çertifikatë sigurie”, për njohje me informacion të klasifikuar”, është dërguar pranë DSIK, lista e funksioneve organike të DPD, të cilat prodhojnë informacion të klasifikuar ose gjatë bashkëpunimit me institucione të tjera, e përftojnë dhe kontaktojnë me këtë kategori informacioni, ku rezulton i përfshirë edhe pozicioni “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit (ku është emëruar nëpunësi *****).

Pas kryerjes së procesit për verifikimin e sigurisë, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka të drejtë të vendosë që të lëshojë, të pezullojë, të refuzojë pajisjen ose mbajtjen e mëtejshme të “çertifikatës së sigurimit të personelit”, (CSP), për një individ të caktuar.

Në rastin e nëpunësit *****, institucioni është shprehur se, ai nuk është i pajisur me këtë çertifikatë, pasi në momentin e transferimit të tij të përkohshëm në atë pozicion

(dt.15.9.2020), institucioni ka qenë dhe është aktualisht, në procesin e rishikimit të listës të dërguar në DSIK, pasi kjo e fundit, me shkresën nr. 180, datë 22.1.2020, ka kërkuar që një numër i konsiderueshëm pozicionesh/funksionesh në DPD, të rivlerësohen pasi nuk duhet të konsiderohen të gjitha në kushtet e “nevojës për njohje” të informacionit të klasifikuar. Ky është një proces që, sipas procedurës së parashikuar nga Vendimi nr. 188, datë 4.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, për kryerjen e verifikimit dhe lëshimin e CSP-së, parashikohet një afat kohor deri në 120 ditë kalendarike, i cili fillon pas paraqitjes së kërkesës nga institucioni dhe pranimit të dokumentacionit nga DSIK.

Në rastin konkret, duke patur parasysh gjithë sa u thanë më sipër dhe meqë jemi para një transferimi të përkohshëm, nga pikëpamja e menaxhimit të drejtë të burimeve njerëzore, duhet që organi drejtues i institucionit dhe njësia e burimeve njerëzore, të kishin treguar kujdes për respektimin e gjithë elementëve të marrëdhënies që krijohet me aktin e transferimit të përkohshëm pasi, në pozicione ku kërkohet certifikata e sigurisë, nuk mund të emërohen, goftë dhe përkohësisht, persona që nuk e plotësojnë kushtin e kërkuar.

Nisur nga sa më sipër, për sa kohë nuk ka përfunduar procesi i nisur për rivlerësimin e listës së pozicioneve që duhet të pajisen me certifikatë sigurie dhe në kushtet kur pozicioni “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Inteligjencës Operative”, në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, në DPD, kërkon që punonjësi i cili do të kryejë këtë detyrë duhet të ketë certifikatën e sigurisë nga DSIK, urdhri nr. 17031, datë 15.9.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *****, bazuar në pikën “d”, të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është i paligjshëm.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, bazuar në nenet 113 dhe 114, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të veprojë menjëherë për shfuqizimin e urdhrit nr. 17031, datë 15.9.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Inteligjencës Operative”, në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit dhe kthimin e këtij të fundit në pozicionin ku ka punuar para këtij transferimi.

Për plotësimin e pozicionit “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Inteligjencës Operative”, në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, në DPD, të tregohet kujdes nga njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithme të Doganave që, për sa kohë ky pozicion kërkon certifikatë sigurie, ti ofrojë drejtuesit të institucionit për

transferim të përkohshëm, vetëm kandidatura që e plotësojnë kushtin e sigurisë të kërkuar nga organi i specializuar.

Nëse pas rivlerësimit të listës së pozicioneve që duhet të pajisen me çertifikatë sigurie, pozicioni në fjalë, do të klasifikohet si pozicion i cili nuk kërkon çertifikatë sigurie, aty mund të emërohet ose transferohet përkohësisht, çdo nëpunës që çmohet nga drejtuesi dhe që plotëson kriteret e tjera që kërkohen për pozicionin e punës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenet 109/d, 113 e 114, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga drejtuesi i institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që, mbështetur nga njësia e burimeve njerëzore, të shfuqizojë urdhrin nr. 17031, datë 15.9.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** në pozicionin *“Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Inteligjencës Operative”*, në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, duke e kthyer nëpunësin në pozicionin ku ai ka punuar para këtij transferimi.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka detyrimin të krijojë kushtet e nevojshme dhe të ndjekë procesin e zbatimit të këtij vendimi.
3. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar,

duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

6. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësi e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha